



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

NJËSIA E HARTIMIT TË DOKUMENTAVE TË TENDERIT

Nr. _____ prot.

Himarë, më ____ . ____ . 2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS LIDHËSE TË IMPIANTIT GJILEKË ME RRUGËN NACIONALE”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45233120-6 Punime ndërtimi për rrugë

VLERA E FONDIT: 208,333,333 (dyqindë e tetë milion e treqindë e tridhjetë e tre mijë e treqinde e tridhjetë e tre lekë) **pa TVSH**, vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë Himarë, i ndarë në dy vite financimi, konkretisht:

- **Viti 2026 83,333,333** (tetëdhjetë e tre milion e treqindë e tridhjetë e tre mijë e treqindë e tridhjetë e tre lekë) **pa tvsh**.

- **Viti 2027 125,000,000** (njëqindë e njëzetë e pesë milion lekë) **pa tvsh**.

Perlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike është kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj)”, Inxhinieri është mbështetur në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:
a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit / kualifikimit (shtojca 7)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore

minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur/ fondit limit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.
Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43,pika 3,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke pasur parasysh që lloji i procedurës është “e hapur”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa “b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: ”Autoriteti/entikontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron

te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontrates.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2025** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar,

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB-së.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dheneni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50 %** e vlerës së përllorë të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit*
- iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
- iv. Aktin e Kolaudimit të objektit*
- v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*

vi. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.

b) Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit
- iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor
- iv. Aktin e Kolaudimit të objektit
- v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**

- NP.1 – Punime Germimi ne toke

Klasifikimi C

- **N.P. 4** - Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale **Klasifikimi D**
- **NP-5**- Punime nentokesore, ura dhe vepra arti **Klasifikimi C**
- **NP-7** Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje **Klasifikimi A**
- **NP-9** Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime **Klasifikimi A**
- **NP-12** Punime te inxhinierise se mjedisit **Klasifikimi E**

▪ **Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:**

- **NS-6**- Sinjalistike rrugore jo ndruicuese **Klasifikimi A**
- **NS-7**-Barriera dhe mbrojtje rrugore **Klasifikimi A**
- **NS-8**-Ndertime betonarme parafabrikat, struktura metalike **Klasifikimi A**
- **NS-18** Punime topogjeodezike **Klasifikimi E**

* *Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e licensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”,neni 8 përcakton "Zbatimi I punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, private ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Certifikatat ISO, si më poshtë:

- **ISO 9001 - 2015** (Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë) e përditësuar
- **ISO 14001-2015** (Për sistemin e menaxhimit të mjedisit) e përditësuar
- **ISO 45001-2018** (Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)

Nese certifikatat jane ne gjuhe te huaj, ato te paraqiten te perkthyer dhe te noterizuara ne gjuhen zyrtare shqipe. Keto certifikata te jene leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Certifikatat duhet te jene te vlefshme ne kohen

e zhvillimit të tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mesipërme sipas natyrës së punimeve

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, si dhe nenit nr. 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe bazuar në nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, të ndryshuar, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Duke qenë se përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi është Autoriteti Kontraktor, gëzon të drejtën për t’u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar”.

- Për ISO 9001 - 2015; Kjo certifikate specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatore si dhe meqënëse Bashkia Himare si Autoritet Kontraktor kërkon që punimet që do të kryhen të jenë në cilësinë më të lartë është përcaktuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me këtë standart cilësie.

- Per ISO 14001 – 2015: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 14001 – 2015, standart ky që vlerëson sipas përkufizimit të tij përgjegjshmërinë e kompanive ndaj mjedisit. Standardet e Sistemit të Menaxhimit - që vlerësojnë nivelin e sistemit të zhvillimit dhe integritetit të përgjegjësive ndaj mjedisit në të gjithë kompaninë. Bashkia Himare si Autoritet Kontraktor kërkon një menaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore.

- Per ISO 45001:2018: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 45001:2018, standart ky që përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikën më të mira të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shëndetësor optimal dhe menaxhimin e sigurisë në punë. Kjo mund të ndihmojë për të vënë në vend politikën, procedurat dhe kontrollet e nevojshme për çdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **100 (njëqindë) punonjës**, me koë të plotë pune, për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi : Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej **100 (njëqindë)** punonjës, për të paktën 3 muajt e fundit, me koë të plotë pune, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, , ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për përmbushjen e këtyre kushteve. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve përfshihen punonjësit inxhinierë, specialistë, punonjës të kualifikuar dhe punëtorë për punime me krahë, drejtuesit e mjeteve të thjeshta apo të rënda etj., duke pasur parasysh njëkohësisht volumin e punimeve. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*. Përlllogaritja e numrit total të punonjësve është bërë në bazë të manualit teknik të punimeve si më poshtë:

2.3.5 **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:**

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, libeze pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Ndërtimi Infrastruktura**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Gjeodet/ Topograf**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Ndërtimi Strukturist**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Hidroteknik**
- Minimuni 1(një) **Inxhinier Mjedisi**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Mekanik**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit* duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi :Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.” Kërkesa për 1 (një) punonjës Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e

përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës, me qëllimin për të pasur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. **Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

- **Inxhinier Ndërtimi Infrastruktura:** Është i nevojshëm për drejtimin teknik të punimeve rrugore, kontrollin e shtresave të rrugës, nënshtresës, asfaltimit, bordurave, trotuareve, sinjalistikës dhe elementeve të tjerë të infrastrukturës. Ai siguron që punimet të kryhen sipas projektit, specifikimeve teknike dhe standardeve të ndërtimit rrugor.
- **Inxhinier Gjeodet / Topograf:** Është i nevojshëm për rievimin e terrenit, piketimin e aksit të rrugës, kuotave, niveletave, pjerrësive dhe verifikimin e volumeve të gërmimit/mbushjes. Pa topografin nuk mund të garantohet saktësia e gjurmës së rrugës dhe përputhja e punimeve me projektin.
- **Inxhinier Ndërtimi Strukturist:** Është i nevojshëm kur gjatë rikonstruksionit preken ose ndërtohen elemente strukturore si mure mbajtëse, tombino, ura të vogla, kuneta betoni, skarpata, bazamente, elemente mbrojtëse apo struktura të tjera betoni. Ai vlerëson qëndrueshmërinë, sigurinë dhe kapacitetin mbajtës të këtyre elementeve.
- **Inxhinier Hidroteknik:** Është i nevojshëm për zgjidhjen e kullimit dhe largimit të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore. Në rikonstruksion rruge, administrimi i ujërave është shumë i rëndësishëm, sepse mosfunksionimi i kanalizimeve, kunetave, tombinove apo drenazheve mund të dëmtojë shtresat rrugore dhe të ulë jetëgjatësinë e objektit.
- **Inxhinier Mjedisit:** Është i nevojshëm për kontrollin e ndikimeve mjedisore gjatë punimeve, si pluhurat, zhurmat, menaxhimi i mbetjeve, largimi i materialeve të gërmuara, mbrojtja e gjelbërimit dhe respektimi i kushteve mjedisore të kantierit. Ai ndihmon që punimet të kryhen pa cenuar mjedisin dhe komunitetin përreth.
- **Inxhinier Mekanik:** Është i nevojshëm për menaxhimin dhe kontrollin teknik të makinerive e pajisjeve që përdoren në kantier, si eskavatorë, fadroma, rulë, asfaltoshtruese, kamionë, kompresorë dhe pajisje të tjera mekanike. Ai garanton funksionimin e sigurt dhe efikas të mjeteve, si dhe ul riskun e defekteve apo aksidenteve në kantier.

- b) Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit të punimeve, si më poshtë:
- Minimuni 2 (dy) **Inxhinier Ndërtimi Strukturist**
 - Minimuni 1 (një) **Inxhinier Gjeodet/ Topograf**
 - Minimuni 1 (një) **Inxhinier Hidroteknik**
 - Minimuni 1 (një) **Inxhinier Mekanik**
 - Minimuni 1 (një) **Inxhinier Elektrik**
 - Minimuni 1(një) **Inxhinier Mjedisi**

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar.
- Te gjithë punojësit e mësipërm duhet të figurojnë në listepagesat të shoqërisë minimalisht për periudhën tre muajt e fundit.
- Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e mesiperm , emer/mbiemer, profili i punës, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numrin e amazes dhe titullin e kualifikimit për diplomën/certifikatën përkatëse si dhe emrin e institucionit që ka lëshuar dokumentin për specialistet e kualifikuar me siper.

Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas deklarata B.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specififikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Numri është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Dy (2) Inxhinierë Ndërtimi Strukturist:** Prania e dy inxhinierëve strukturistë justifikohet kur objekti përfshin një numër të konsiderueshëm elementesh strukturore, si mure mbajtëse, tombino, vepra arti, kanale betoni, pritëse e shkarkuese ujërash, mbrojtje skarpatah, si dhe struktura të tjera betoni të armuar. Njëri inxhinier mund të mbulojë kontrollin e zbatimit të punimeve strukturore në terren, ndërsa tjetri verifikimin e cilësisë, përputhshmërisë me projektin dhe monitorimin e proceseve teknike. Kjo bëhet veçanërisht e nevojshme në objekte me volum të madh punimesh ose me disa fronte pune.
- **Inxhinier Gjeodet / Topograf:** Është specialisti përgjegjës për rilevimet topografike, piketimin e aksit të rrugës, kontrollin e kuotave, niveletave, koordinatave dhe volumeve të gërmimeve e mbushjeve. Ai garanton që punimet të realizohen sipas koordinatave dhe parametrave të projektit, duke shmangur devijimet gjeometrike që mund të ndikojnë në funksionalitetin dhe sigurinë e rrugës.
- **Inxhinier Hidroteknik:** Në çdo rikonstruksion rruge, sistemi i kullimit është një nga elementet më kritikë për jetëgjatësinë e investimit. Inxhinieri hidroteknik mbikëqyr zbatimin e kunetave, drenazheve, tombinove, kanaleve të ujërave sipërfaqësore dhe strukturave të tjera hidraulike, duke siguruar që ujërat të mos dëmtojnë trupin e rrugës dhe veprat përbërëse të saj.
- **Inxhinier Mekanik:** Punimet rrugore realizohen me një flotë të konsiderueshme makinerish dhe pajisjesh të rënda, si eskavatorë, buldozerë, rulë, asfaltshtruese, grejderë, kompresorë dhe mjete transporti. Inxhinieri mekanik siguron kontrollin teknik, mirëmbajtjen, funksionimin dhe eficiencën e këtyre pajisjeve, duke minimizuar ndërprerjet dhe rreziqet operative gjatë zbatimit të kontratës.
- **Inxhinier Elektrik:** Prania e tij justifikohet kur projekti përfshin elemente të infrastrukturës elektrike, si ndriçim rrugor, kabina elektrike, linja furnizimi, sinjalistikë ndriçuese, semaforë, sisteme monitorimi apo pajisje të tjera elektroteknike. Ai garanton që instalimet elektrike të realizohen sipas standardeve të sigurisë dhe kërkesave teknike të projektit.
- **Inxhinier Mjedisi:** Ky specialist është i nevojshëm për monitorimin e ndikimeve mjedisore gjatë punimeve, menaxhimin e mbetjeve të ndërtimit, kontrollin e pluhurave dhe zhurmave, administrimin e materialeve të gërmuara dhe respektimin e kushteve të lejes mjedisore. Roli i tij është i rëndësishëm për garantimin e përputhshmërisë së projektit me legjislacionin mjedisor dhe minimizimin e ndikimit të komuniteti dhe ekosistemi.

Kërkesat e mësipërme bazohen në piken 4 Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 39 pika 6/c të VKM nr. 285 dt. 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar, si dhe bazuar në rregullore “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre” miratuar me urdhrin nr. 200 dt. 16. 05. 2019 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës.

- c) Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit të punimeve, si më poshtë:
- Teknik i Ndërtimi - jo më pak se **1 (një)** punonjës
 - Teknik Mekanik - jo më pak se **1 (një)** punonjës
 - Hidraulik – jo më pak se **2 (dy)** punonjës

- Saldator – jo më pak se	1 (<i>nje</i>) punonjës
- Hekurthyes - jo më pak se	2 (<i>dy</i>) punonjës
- Kaperntier - jo më pak se	5 (<i>pese</i>) punonjës
- Betonues – jo më pak se	2 (<i>dy</i>) punonjës
- Hidroizolues – jo më pak se	3 (<i>tre</i>) punonjës
- Elektracist – jo më pak se	1 (<i>nje</i>) punonjës
- Asfaltoshtrues –	2 (<i>dy</i>) punonjes

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Numri është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

- **Teknik Ndërtimi – minimum 1 punonjës:** Tekniku i ndërtimit është i nevojshëm për organizimin dhe ndjekjen e përditshme të punimeve në kantier. Ai asiston stafin inxhinierik në kontrollin e cilësisë, matjen e punimeve, mbajtjen e dokumentacionit teknik dhe koordinimin e proceseve të zbatimit. Prania e tij garanton monitorimin e vazhdueshëm të ecurisë së punimeve dhe respektimin e specifikimeve teknike.
- **Teknik Mekanik – minimum 1 punonjës:** Tekniku mekanik është i nevojshëm për kontrollin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e pajisjeve dhe makinerive të përdorura në kantier. Ai siguron që mjetet dhe pajisjet të jenë në gjendje teknike optimale, duke shmangur ndërprerjet e punimeve dhe duke garantuar sigurinë operacionale.
- **Hidraulik – minimum 2 punonjës:** Hidraulikët janë të nevojshëm për realizimin e sistemeve të kanalizimit, kullimit dhe rrjeteve të largimit të ujërave. Ata kryejnë montimin e tubacioneve, lidhjen e elementeve hidraulike dhe kontrollin e funksionimit të sistemeve, të cilat janë elemente thelbësore për funksionimin dhe jetëgjatësinë e infrastrukturës rrugore.
- **Saldator – minimum 1 punonjës:** Saldatori është i nevojshëm për montimin, bashkimin dhe riparimin e elementeve metalike që përdoren gjatë realizimit të veprës. Ai garanton cilësinë e lidhjeve metalike dhe sigurinë strukturore të elementeve që kërkojnë përpunim ose montim me saldim.
- **Hekurthyes – minimum 2 punonjës:** Hekurthyesit janë të nevojshëm për përgatitjen, prerjen, përkuljen dhe montimin e armaturave metalike që përdoren në elementët betonarme. Prania e tyre siguron realizimin korrekt të strukturave të armuara sipas kërkesave teknike dhe projektit.
- **Karpentier – minimum 5 punonjës:** Karpentierët janë të nevojshëm për ndërtimin dhe montimin e kallëpeve, skelave, mbështetëseve dhe strukturave të përkohshme që përdoren gjatë realizimit të elementeve të betonit. Ata luajnë rol të rëndësishëm në garantimin e formës, dimensioneve dhe cilësisë së elementeve ndërtimore gjatë procesit të betonimit.

- **Betonues – minimum 2 punonjës:** Betonuesit janë të nevojshëm për përgatitjen, hedhjen, sistemimin dhe trajtimin e betonit në elementët konstruktivë të objektit. Ata sigurojnë që procesi i betonimit të kryhet sipas standardeve teknike dhe kërkesave të projektit.
- **Hidroizolues – minimum 3 punonjës:** Hidroizoluesit janë të nevojshëm për realizimin e shtresave mbrojtëse kundër depërtimit të ujit dhe lagështirës në elementët e ndryshëm të veprës. Prania e tyre kontribuon në rritjen e qëndrueshmërisë dhe jetëgjatësisë së strukturave dhe elementeve ndërtimore.
- **Elektricitist – minimum 1 punonjës:** Elektricitisti është i nevojshëm për instalimin, lidhjen, testimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve elektrike që përfshihen në objekt. Ai garanton që instalimet elektrike të realizohen në përputhje me normat e sigurisë dhe kërkesat teknike.
- **Asfaltoshtrues – minimum 2 punonjës:** Asfaltoshtruesit janë të nevojshëm për realizimin e shtresave asfaltike, shpërndarjen, nivelimin dhe sistemimin e materialit asfaltik gjatë procesit të shtrimit. Ata kontribuojnë drejtpërdrejt në cilësinë, rrafshësinë dhe qëndrueshmërinë e sipërfaqes rrugore.

a) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar në licencë **1 (një)** Punonjës të certifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” gjatë kryerjes së veprimtarisë , në përputhje me klauzolat e ligjit Nr.10431 datë 09/06/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i cili duhet të figurojë në listëpagesa të shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontratë të vlefshme pune, dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimit nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

- a) 1(një) punonjës që disponon certifikatën si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë”.
- b) 1 (nje) inxhinier ”Auditues/Inspektues i Sigurisë Rrugore”, i certifikuar sipas VKM nr 125 date 23.02.2011 "Për miratimin e. Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Rrugore” dhe Udhezimit Nr 9 date 3.07.2012 “Mbi auditimin dhe inspektimin e sigurisë rrugore”. (pranohet edhe me kontrate sherbimi).

- c) 1 (një) Inxhinieri, drejtues teknik, duhet të jetë i specializuar si ekspert mjedisor në auditimin mjedisor dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis, të vërtetuar me çertifikatë për “*Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis*”, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, i cili të figurojë në listpagesat e shoqërisë për periudhën 12 muajt e fundit
- d) 1 (një) Auditues energjetik, i pajisur me çertifikatën e Audituesit Energjetik
- e) Operatori ekonomik duhet të disponojë 1(nje) punojës i cili të jetë i pajisur me çertifikatë “*Ekspert Zjarrfikës*” në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpëtimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, Libreze pune si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, Ose të sigurohet nga operatori ekonomik nepermjet kontraktimit.
- f) Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë staf (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:
- 1 (një) punonjës i certifikuar si Specialist Për Testimin e Performancës së Materialeve/ Produkteve të Ndërtimit.
- g) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Libreze pune (përkatëse)
 - CV përkatëse
 - Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
 - Diplomë
 - Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme janë vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin Teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin Teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Në Kreun IV të

VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 1 “Drejtuesi teknik i shoqërisë”, gërma b) parashikohet: “Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të komisionit për dokumentacionin e paraqitur. Përcaktimi i kërkeses për Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt garanton autoritetin jo vetëm për angazhimin tere kohen e kryerjes se punimeve te nje drejtuesi teknik te shoqerise por dhe si orientim per nje person kontakti dhe ure lidhese mes mbikqyresit te punimeve dhe AK per problematiken qe do te haset gjate realizimit te punimeve.

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme janë vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

a) Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave: Punimet rrugore zhvillohen në kantier të hapur, me përdorim makinerish të rënda, gërmime, punime në lartësi dhe qarkullim mjetesh. Prania e një personi të trajnuar për ndihmën e parë dhe menaxhimin e emergjencave kontribuon në sigurinë dhe reagimin e shpejtë në rast aksidenti apo emergjence në punë.

b) Auditues / Inspektues i Sigurisë Rrugore: Objekti lidhet drejtpërdrejt me infrastrukturën rrugore. Audituesi i sigurisë rrugore mund të kontribuojë në:

- verifikimin e elementeve të sigurisë rrugore;
- sinjalistikën vertikale dhe horizontale;
- barrierat mbrojtëse;
- sigurinë e përdoruesve të rrugës.

Megjithatë, duke qenë se ligji parashikon që auditimi i sigurisë rrugore zakonisht kryhet në fazën e projektimit ose nga struktura të specializuara, kërkesa bëhet më e pranueshme kur autoriteti lejon edhe **kontratë shërbimi**, siç është parashikuar këtu.

c) Inxhinier i specializuar si ekspert mjedisor në VNM (Vlerësim Ndikimi në Mjedis): Ky specialist nevojitet kryesisht për:

- hartimin e raporteve të VNM-së;
- procedurat e pajisjes me leje mjedisore;
- auditimin mjedisor të projekteve.

Në fazën e **zbatimit të punimeve**, zakonisht mjafton një inxhinier mjedisi ose specialist mjedisor për monitorimin e kushteve mjedisore. Një ekspert i certifikuar për VNM është zakonisht i nevojshëm në fazën e projektimit dhe autorizimit mjedisor, jo domosdoshmërisht gjatë ekzekutimit të kontratës. Prandaj kjo kërkesë mund të konsiderohet e **tepruar** nëse autoriteti nuk argumenton nevojën konkrete.

d) Auditues Energjetik: Audituesi energjetik kryen:

- auditime të konsumit energjetik;
- analiza të eficiencës energjetike të ndërtesave;
- vlerësime të performancës energjetike.

Objekti në fjalë është rikonstrukcion rruge dhe nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me auditimin energjetik të ndërtesave apo sistemeve energjetike. Përveç nëse projekti do të kishte një komponent të veçantë të eficiencës energjetike, kërkesa për auditues energjetik nuk duket e lidhur me objektin e kontratës. Kjo është ndoshta një nga kërkesat më të dobëta për t'u mbrojtur juridikisht.

e) Ekspert Zjarrfikës: Në një kantier ndërtimi ekzistojnë:

- karburante;
- makineri;
- pajisje elektrike;
- punime saldimi.

Prandaj nevojiten masa për mbrojtjen nga zjarri.

Megjithatë, kërkesa për një **Ekspert Zjarrfikës të certifikuar sipas ligjit** mund të konsiderohet më e lartë se sa nevojitet për një kontratë rrugore, pasi zakonisht mjafton:

- plani i mbrojtjes nga zjarri;
- pajisjet kundër zjarrit;
- trajnimi i personelit.

Fakti që lejohet kontraktimi i jashtëm e bën kërkesën më të pranueshme.

f) Specialist për Testimin e Performancës së Materialeve / Produkteve të Ndërtimit: Në një kontratë rrugore duhet të kontrollohen:

- agregatet;
- materialet e mbushjes;
- betoni;
- asfalti;
- armaturat;

- materialet e drenazhimit.

Kontrolli laboratorik dhe verifikimi i performancës së materialeve janë elementë thelbësorë për cilësinë e veprës. Ky specialist lidhet drejtpërdrejt me garantimin e cilësisë së punimeve dhe është proporcional me objektin e kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi: Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi:

- Eskavatoriste – jo më pak se 3 (tre) punonjës
- Buldozerist – jo më pak se 1 (nje) punonjës
- Automakinist – jo më pak se 2 (dy) punonjës
- Shofer – jo më pak se 4 (kater) punonjës

, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6 në rastin kur mjetet/ makineritë e deklaruara janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:**

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- (Dëshmi te Aftësisë Profesionale), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe referuar Kodit Rrugor, e cila duhet te perkoje me kerkesat e profilit te deklaruar per cdo punojes.
- Të figurojnë në listëpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipër duhet të figurojnë te regjistruar sipas legjisllacionit ne fuqi.
- Gjate fazes se ofertimit në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, pika B. Deklarata -“Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik per punonjesisit eskavatoriste, automakinist, shofer, duhet të deklarojnë: emer/mbiemer, profilin e punes, daten e kontrates se punes, numrin e deshmise së aftësisë profesionale dhe daten e vlefshmerise se saj.

Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atehere eskavatorist / buldozeristet , automakinistet, dhe shoferet nuk ka nevojë që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E. ofertues.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përquindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

AK rezervon te drejten e verifikimit te deklarimeve per punojesit e mesiperm, cdo informacion i rreme apo i devijuar nga kerkesat e mesiperme do te jete kusht per skualifikimin e ofertes.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës., të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Manovratorët dhe shoferët janë te nevojshem per shkak te makinerive te ndryshme qe do te kryejne punime germimi, ngjeshje materiali etj.

2.3.7 (Makineri, Pajisje)

a) **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë,** automjetet, makineritë dhe pajisjet (**sipas tabelës**) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 10 ton	në pronësi ose me qira	Copë 4
2	Greider	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Rul gomë-hekur	në pronësi ose me qira	Copë 2
4	Rul gomë-gomë	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 3
6	Autopompë betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Autobitumatriçe	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Minifadromë	në pronësi ose me qira	Copë 2
11	Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 2
12	Eskavatorë me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
13	Eskavatorë me zinxhirë	në pronësi ose me qira	Copë 5
14	Fadromë me goma	në pronësi ose me qira	Copë 2
15	Makineri vijëzimi	në pronësi ose me qira	Copë 1
16	Makineri për vendosje guardrail (Batipal)	në pronësi ose me qira	Copë 1
17	Fabrikë Betoni (e pajisur me leje mjedisore kodit III.1.B (jo më larg se 50 km nga objekti)	në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi	Copë 1
18	Fabrikë asfalti (e pajisur me leje mjedisore kodit III.1.B) (jo më larg se 50 km nga objekti)	në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi	Copë 1
19	Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore kodit III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi	Copë 1
20	Kamioncine me kapacitet mbajtës 1.5 – 2 ton	në pronësi / me qira	Copë 1
21	Rimorkiator për transportin e makinerive me kapacitet mbajtës min 30 ton.	në pronësi / me qira	Copë 1
22	Koke Terheqese	në pronësi / me qira	Copë 1
23	Fshese me goma	në pronësi / me qira	Copë 1
24	Gjeneratora mbi 100 kva	në pronësi / me qira	Copë 2

25	Frez asfalti	në pronësi / me qira	Copë 1
26	Betoniere kantieri	në pronësi / me qira	Copë 2
27	Prerese Asfalti	në pronësi / me qira	Copë 2
28	Depozita uji minimumi 20,000 litra	në pronësi / me qira	Copë 2
29	GPS	në pronësi / me qira	Copë 1
30	Total Station	në pronësi / me qira	Copë 1
31	Kulle ndricimi	në pronësi / me qira	Copë 2
32	Kontenier per zyra	në pronësi / me qira	Copë 1
33	Paisje per largimin e ujrave	në pronësi / me qira	Copë 2
34	Matrapik	në pronësi / me qira	Copë 2
35	Pompe stacionere	në pronësi / me qira	Copë 1

b) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – *jo më pak se 50 copë*
- Komplet i ndihmës së shpejtë – *jo më pak se 5 copë*
- Fikëse zjarri të lëvizshme – *jo më pak se 10 copë*
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – *jo më pak se 30 copë*

□ **Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të mjeteve/ makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:**

- 1- **Për mjetet me goma që shënohen në rregjistra publike** duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 2- **Për mjetet e siguruar me qira**, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 3- **Për paisjet/ makineritë në pronësi** të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).
- 4- **Për paisjet/ makineritë me qera** të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik1” në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në nenin 39 pika 6 d “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6/d të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 parashikohet: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon... mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”*

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj njësia e prokurimit vendosi që të kërkojë që operatorët ekonomike të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme sepse ato nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë bazuar sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjeti kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomike dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar në procedurën e prokurimit është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të tyre. Përsa më sipër, numri i mjeteve është përcaktuar në bazë të nevojës pasi objekti zhvillohet në një kohë të shkurtër, pa cenuar grafikun e përcaktuar të punimeve dhe, veç të tjerash, Në lidhje me kriterin për disponimin e makinerive dhe pajisjeve, njësia e prokurimit vlerëson se referuar përmasave dhe volumit të punimeve objekt kontrate, operatorëve ekonomike u lind e nevojshme disponimi i makineri pajisjeve.

Ndërsa mjetet dhe pajisjet të mbrojtjes në punë të punëtorëve, si dhe të personelit, janë kërkuar në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë: 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”. Njësia e prokurimit vlerëson se pa këto mjete një operator ekonomik nuk mund të realizojë punët e parashikuara në këtë objekt prokurimi. Ruajtja dhe siguria në punë të jetëve njerëzore, është përparësi dhe detyrim ndaj punonjësve.

Shënim: Makineritë dhe pajisjet, janë kërkuar në bazë të specifikës së punës, volumit dhe punimeve paralele në katër fronte me shtrirje të gjerë gjeografike, kjo sipas gjurmëve dhe zbatimit të projektit të miratuar për punimet në terren.

2.3.13 Operatori ekonomik duhet të ketë kontratë me një laborator të akredituar ku të jetë përcaktuar objekti i kontratës/procedurës, për kryerjen e testimeve gjatë fazës së zbatimit si dhe përfundimit të objektit. Laboratori duhet të jetë i akredituar për testet e poshtë shënuar, të certifikuar në përputhje me SSHEN 12390-3:2019 ASTM C39/C39M, SSH EN 1744- 1:2009+A1:2012, SSHEN 12390-3:2019 ASTM C39/C39M.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik1” në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në nenin 39 pika 6 d “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6/d të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon... mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë kontratë me një laborator të akredituar për kryerjen e testimeve gjatë fazës së zbatimit dhe në përfundim të punimeve është e nevojshme për të garantuar kontrollin e cilësisë së materialeve dhe të punimeve që do të përdoren në realizimin e objektit. Laboratori i akredituar shërben për të verifikuar në mënyrë të pavarur dhe sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare nëse materialet e përdorura dhe punimet e realizuara përmbushin kërkesat teknike të projektit, specifikimeve teknike dhe standardeve të ndërtimit.

Konkretisht:

- **SSH EN 12390-3:2019 / ASTM C39/C39M** janë standarde që përdoren për përcaktimin e rezistencës në shtypje të betonit. Këto testime janë të nevojshme për të verifikuar nëse betoni i përdorur në mure mbajtëse, tombino, puseta, elemente betonarme dhe struktura të tjera arrin parametrat e projektuar të qëndrueshmërisë dhe sigurisë.
- **SSH EN 1744-1:2009+A1:2012** përdoret për testimin e agregateve dhe materialeve inerte që përdoren në beton, shtresa rrugore dhe punime të tjera ndërtimore. Nëpërmjet këtyre provave verifikohet cilësia, pastërtia dhe përshtatshmëria e materialeve që do të inkorporohen në objekt.

Prania e një laboratorit të akredituar siguron që:

- materialet e ndërtimit të jenë në përputhje me standardet teknike;
- të evidentohen në kohë devijimet ose mangësitë në cilësinë e materialeve;
- të garantohet jetëgjatësia dhe siguria e veprës;
- autoriteti kontraktor të ketë prova të dokumentuara mbi cilësinë e punimeve gjatë marrjes në dorëzim të objektit.

Për rrjedhojë, kërkesa për kontratë me laborator të akredituar lidhet drejtpërdrejt me kontrollin e cilësisë së punimeve dhe garantimin e realizimit të objektit sipas parametrave teknikë të

projektit, duke përbërë një kërkesë proporcionale dhe të domosdoshme për kontrata të natyrës së infrastrukturës rrugore.

- 2.3.14 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencat e nevojshme (lëshuar nga QKL) për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë licencë të vlefshme:
- Licëse nga QKB me Kod 1.2.A. për Mbrojtjen nga Zjarri .
 - Licence nga QKB me Kod III.2. B “Për Grumbullim dhe Transportim i mbetjeve te parrezikshme inerte dherave” te pajisur me kodin Unik.
 - Leje Mjedisi te tipit C Kodi III.1.A “Per trajtimin e ujerave te zeza”
 - Licence nga QKB me Kod III.2. B “Transportim i ujrave te ndotura urbane, llumrave skeptike dhe ujrave te zeza” te pajisur me kodin Unik.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik1” në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në nenin 39 pika 6 d “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6/d të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon... mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

Licencë QKB Kodi 1.2.A – Mbrojtja nga Zjarri

Kjo licencë nevojitet kur gjatë zbatimit të punimeve përdoren:

- karburante dhe lubrifikantë për makineritë;
- pajisje elektrike;
- procese saldimi dhe prerjeje metalike;
- depo materiale dhe kantier ndërtimi.

Qëllimi është garantimi i masave të sigurisë kundër zjarrit në kantier dhe respektimi i kërkesave të mbrojtjes së jetës dhe pronës gjatë zhvillimit të punimeve.

Megjithatë, zakonisht kjo nevojë mbulohet me planin e mbrojtjes nga zjarri dhe jo domosdoshmërisht me posedimin e licencës 1.2.A nga vetë operatori ekonomik.

2. Licencë III.2.B – Grumbullim dhe Transportim i Mbetjeve të Parrezikshme Inerte dhe Dherave

Kjo licencë është drejtpërdrejt e lidhur me zbatimin e punimeve.

Gjatë rikonstruksionit të rrugës krijohen:

- dhera nga gërmimet;
- materiale të prishura;
- mbetje inerte nga betonet, trotualet dhe elementët ekzistues.

Këto materiale duhet të largohen dhe të depozitohen në vendet e miratuara sipas legjislacionit mjedisor. Për këtë arsye kërkohet licenca për grumbullimin dhe transportimin e tyre.

3. Leje Mjedisi Tipi C – Trajtimi i Ujërave të Zeza

Argumenti i mundshëm është se në kantier mund të krijohen:

- ujëra teknologjikë;
- ujëra nga aktivitetet e përkohshme të personelit;
- ujëra të ndotura nga larja e pajisjeve.

Autoriteti kontraktor mund të synojë që operatori të ketë kapacitete për menaxhimin e tyre sipas kërkesave mjedisore.

Megjithatë, për një rikonstrukcion rruge zakonisht operatori nuk kryen vetë trajtimin e ujërave të zeza dhe kjo veprimtari realizohet nga subjekte të specializuara. Për këtë arsye lidhja me objektin e kontratës nuk është gjithmonë e drejtpërdrejtë.

4. Licencë III.2.B – Transportim i Ujërave të Ndotura Urbane, Llumrave Septike dhe Ujërave të Zeza

Kjo licencë mund të kërkohet për rastet kur:

- kantieri përdor tualete kimike ose sisteme të përkohshme sanitare;
- krijohen ujëra të ndotura që duhet të largohen nga vendi i punimeve;
- kërkohet menaxhimi i mbetjeve të lëngshme sipas legjislacionit mjedisor.

Qëllimi është sigurimi i një menaxhimi të kontrolluar dhe ligjor të mbetjeve të lëngshme gjatë periudhës së zbatimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJESIA E PROKURIMIT